

VENDIM
Nr. 550, datë 27.7.2016

**PËR BARAZIMIN E MASËS SË SHITESËS SË PENSIONEVE TË POSAÇME
SHTETËRORE, TË CAKTUARA NË HARKUN KOHOR 1.10.1993–31.12.2014, DHE
INDEKSIMIN E PENSIONEVE TË POSAÇME E TË SHITESËS SË PENSIONEVE
TË POSAÇME SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 429, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në masën e pensionit maksimal, në harkun kohor 1.10.1993–31.12.2014, të cilat vazhdojnë të paguhen edhe sot, do të bëhen 24 872 (njëzet e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë në muaj, me kusht që shuma e kësaj shtese, bashkë me masën e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, përjashtuar shtesën sipas nenit 33, të këtij ligji, të mos kalojë vlerën 49 744 (dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër) lekë në muaj.

2. Në të njëjtën masë do të kalojnë edhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave në harkun kohor 1.10.1993–31.12.2014, për familjarët e personit të vdekur, që merrte ose i takonte të merrte pension të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm.

3. Pas këtij ndryshimi, të gjitha pensionet e posaçme dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, përfshirë edhe ato që nuk janë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, do të indeksohen me 1, 6%.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2016, përlogariten në shumën 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë dhe përballohen nga fondet e sigurimeve shoqërore, të parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2016.

5. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të nxjerrë udhëzimet përkatëse teknike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama